



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATË/A:</b>	19.06.2019
<b>REFERENC-Ë:</b>	18/3823/451/DMMU
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"I. Seferi" Sh.p.k. Gjinoc- Suharekë Bazën e asfaltit në zonën Industriale Suharekë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Z. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për Leje Mjedisore

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "I. Seferi" Sh.p.k. Gjinoc- Suharekë, me nr. prot. 18/3823/451/DMMU, të datës: 28.06.2018.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

1. Vendimi për Leje Mjedisore për kompaninë "I. Seferi" Sh.p.k. Gjinoc- Suharekë, për bazën e asfaltit në zonën Industriale Suharekë.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

#### **V E N D I M**

#### **Leje Mjedisore**

Kompanisë "I. Seferi" Sh.p.k. Gjinoc- Suharekë, për bazën e asfaltit në zonën Industriale Suharekë.

#### **A r s y e t i m**

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, vizitës në teren dhe shqyrtimit të informatave shtesë për kompaninë "I. Seferi" Sh.p.k. Gjinoc- Suharekë, për bazën e asfaltit në ngastrën kadastrale nr. P- 72116046 - 02785-37, zona kadastrale Suharekë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për leshuarjen e Lejes Mjedisore.

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike, vlerat kufitare të emisioneve, cilësisë së ajrit të jenë në nivelin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;
- Raporti i rezultateve të monitorimit për vlerat kufitare të emisioneve, cilësisë së ajrit sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion të i dorëzohet MMPH-s;

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë  
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: [zsp.mmph@ks-gov.net](mailto:zsp.mmph@ks-gov.net)





- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPH;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
- Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të kthej lokacionin në gjendjen e mëparshme.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2. të Ligjit për Mbrojtje e Mjedisit Nr. 03/L-25 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 18/3823/ZSP/319/19 datë: 19.06.2019.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPH-së



Faqe 3 nga 3